

*Durrës më 15.04.2026*

## **FTESA**

**Drejtuar:** Personave të interesuar

**Lënda:** Thirrje për pozicionin e punës: Gazetar/e

**Pozicioni specifik:** Gazetar/e multimedial

**Vendndodhja:** Selia e Qendrës Amfora, Durrës, Rruga Aleksandër Goga

(<https://maps.app.goo.gl/13R6PtCF1xjVJAYu8>)

**Raporton te:** Drejtori Ekzekutiv i Qendrës Amfora

**Tipi i kontratës:** Me kohë të plotë

**Fusha:** OJF / Media / Projekte me donatorë

---

### **Përmbledhje e pozicionit:**

Qendra Amfora, publikuese e medias Amfora.al, është në kërkim të një gazetari/e për krijim multimedial për t'iu bashkuar ekipit tonë. Kërkojmë një profesionist/e të motivuar për të prodhuar përmbajtje të sakta dhe me interes publik, duke mbuluar tema që përfshijnë sigurinë, ekonominë dhe zhvillimet aktuale, në përputhje me standardet profesionale. Ky rol kërkon aftësi në identifikimin dhe zhvillimin e historive, me fokus në gazetarinë hulumtuese, si dhe angazhim në shkrimin e artikujve dhe reportazheve.

Pozicioni përfshin gjithashtu krijimin e përmbajtjeve multimediale (foto dhe video), duke përfshirë editimin (montazhin) e materialeve të realizuara me celular apo kamera profesionale, si dhe përvojë të mëparshme në këtë fushë. Roli kërkon respektim të praktikave të sigurta gjatë punës në terren dhe online, verifikim të fakteve dhe burimeve, si dhe bashkëpunim të ngushtë me ekipin editorial.

### **Përgjegjësitë kryesore:**

Ky rol kërkon aftësi në identifikimin dhe zhvillimin e historive që lidhen me çështje të sigurisë, ekonomi, aktualitet politik, si dhe tema sociale dhe kulturore, me fokus në gazetarinë hulumtuese. Përfshin shkrimin e artikujve dhe reportazheve, si dhe krijimin e përmbajtjeve multimediale, përfshirë foto dhe video, si në terren ashtu edhe për platformat digjitale.

Roli kërkon gjithashtu aftësi në editimin (montazhin) e videove dhe përpunimin e fotove, të realizuara me celular apo kamera profesionale, si dhe përvojë të mëparshme në këtë fushë.

Ky pozicion kërkon verifikim të fakteve dhe burimeve, bashkëpunim me ekipin editorial dhe respektim të standardeve profesionale, etike dhe të sigurisë gjatë raportimit, si në terren ashtu edhe online.

---

### **Kualifikimet dhe kërkesat:**

Diplomë universitare në:

- Diplomë në gazetari, komunikim, shkenca sociale ose fusha të ngjashme (ose përvojë ekuivalente)
- Përvojë e mëparshme në këtë fushë
- Njohuri në përdorimin e platformave digjitale dhe mediave sociale, si dhe aplikacioneve bazë për gazetari si Microsoft Word, Google Docs, Canva, CapCut ose Adobe Premiere Pro
- Aftësi shumë të mira në shkrim dhe komunikim në gjuhën shqipe, si dhe mendim kritik mbi çështjet publike
- Njohuri bazë në prodhimin multimedial, përfshirë realizimin dhe editimin e videove, janë të preferueshme

---

### **Orari i punës:**

E hënë - e premte: 08:30 - 16:30;

E shtunë: 08:30 - 13:30;

E dielë: Pushim;

*\*Orari mund të rakordohet sipas nevojave të projekteve specifike, por ai nuk i kalon 48 orë punë në javë.*

---

### **Avantazhe të tjera:**

Përvojë në gazetari hulumtuese ose raportim në terren

Aftësi në prodhimin dhe editimin e përmbajtjeve multimediale (video, foto)

Njohje e gjuhës angleze ose gjuhëve të tjera të huaja

Njohuri të avancuara në përdorimin e mjeteve digjitale si Canva, CapCut apo Adobe Premiere Pro

---

### **Cfarë ofron Amfora.al:**

Mundësi për zhvillim profesional në një organizatë me mision të qartë dhe ndikim publik.

Ambient pune bashkëpunues dhe fleksibël.

Përfshirje në projekte të rëndësishme në fushën e medias, edukimit dhe shoqërisë civile.

Promovim, mbështetje dhe përfshirje në rrjete profesionistësh të ngritura nga donatorët brenda dhe jashtë vendit, si në Ballkan, Evropë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

---

### **Si të aplikoj?!:**

#### **Faza fillestare e aplikimit:**

Dërgoni në adresën e emailit:

qendraamfora@gmail.com

1. CV (Curriculum Vitae);
2. Letër interesi - e personalizuar, ku shpjegon motivimin për pozicionin dhe përputhjen me misionin e Qendrës;
3. Emrat dhe kontaktet e dy referencave profesionale.

---

### Faza e intervistës

**(për kandidatët e përzgjedhur - me email do të njoftohen vetëm ata që kalojnë në këtë fazë):**

1. Diploma universitare (kopje ose e skanuar) ose ekuivalente;
2. Certifikata trajnimesh relevante.

---

### Faza finale (për kandidatin e përzgjedhur):

1. Dëshmi penaliteti (e pastër dhe të mos jetë më e vjetër se 3 muaj);
2. Vërtetim nga prokuroria e juridiksionit përkatës që nuk është në ndjekje penale dhe nga gjykata se nuk është në proces gjyqësor;
3. Deklaratë personale mbi konfliktin e interesit (deklaratë e thjeshtë që nënshkruhet nga aplikanti i përzgjedhur);
4. Deklaratë kofidencialiteti (deklaratë e thjeshtë që nënshkruhet nga aplikanti i përzgjedhur se do të ruajë sekretin tregtar, të dhënat kofidenciale, personale etj., që lidhen me detyrat e tij);
5. Të dhëna personale, si adresa e banimit, kopje e letërnjftimit, llogaria bankare në monedhën "Lek" (për qëllime kontraktimi dhe finalizimi të kontratës së punës).

---

### Kriteret e vlerësimit:

Nr	Kriteri i vlerësimit	Përshkrimi	Pesha (%)	Pikët (1-10)	Pikët e ponderuara
1	Eksperiencia profesionale	Ekspierencë në gazetari ose fusha të ngjashme në raportim dhe shkrim	30%		
2	Aftësi në shkrim	Aftësi të mira për të shkruar qartë dhe saktë në gjuhën shqipe	20%		
3	Aftësi digjitale	Njohuri në përdorimin e platformave online si Google Docs, Microsoft Word, Canva, si dhe aplikacione për editim video si CapCut ose Adobe Premiere Pro	20%		

<b>Nr</b>	<b>Kriteri i vlerësimit</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Pesha (%)</b>	<b>Pikët (1-10)</b>	<b>Pikët e ponderuara</b>
4	Aftësi në Multimedia	Njohuri në realizimin dhe editimin e përmbajtjeve video janë të preferueshme	10%		
5	Punë në terren	Gatishmëri për raportim në terren dhe mbulim të zhvillimeve në kohë reale	10%		
6	Etika profesionale	Respektim i standardeve etike dhe përgjegjësi në raportim	10%		
	<b>TOTALI</b>		<b>100%</b>		